

Skema e nëngrantimit është zbatuar në kuadër të projektit **“Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen..”**, mbështetur nga Komisioni Europian

Zhvilluar në bashkëpunim me Instituti i Studimeve Politike dhe Civil Rights Defenders

Organizata zbatuese e nëngrantit: **Fondacioni “Së Bashku”**

Zona e zbatimit: Durrës

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është promovimi i pjesëmarrjes aktive të personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike duke ushtruar të drejtën e tyre për të votuar dhe duke tërhequr vëmendjen e partive politike ndaj këtij grupi shoqëror dhe elektoratit.

Nëpërmjet zbatimit të kësaj nisme, synohet të arrihen objektivat e posaçëm:

1. Për një periudhë 9 mujore, 10 organizata të personave me aftësi të kufizuara dhe aktivistë do të fuqizohen mbi të drejtën e tyre për të votuar dhe monitoruar në mënyrë proaktive procesin para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve duke përgatitur një Manifest për partitë politike dhe 2 përmbledhje politikash për palët e interesuara përkatëse
2. Projekti do të ndërtojë fushatë ndërgjegjësimi për të sjellë në vëmendje të 6 partive politike gjatë periudhës zgjedhore, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe për të përfshirë rekomandimet/shqetësimet e tyre në programet dhe fjalimet e tyre publike.

Rezultatet të cilat synohen të arrihen nëpërmjet ndërmarrjes së aktiviteteve të planifikuara janë:

1. 10 organizata të përfshira në proceset zgjedhore që do të mbahen në vitin 2021 në Shqipëri;
2. 15 persona me aftësi të kufizuara të aftë për të monitoruar gjatë zgjedhjeve;
3. Një Manifest dhe dy përmbledhje politikash të finalizuara, duke pasqyruar shqetësimet dhe rekomandimet e personave me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në programet politike dhe fjalimet publike;
4. Takime me 6 parti politike dhe kandidatë për të prezantuar çështjet më shqetësuese për personat me aftësi të kufizuara, për t'u pasqyruar në programet dhe fjalimet e tyre publike;
5. Fushata publike për të pasqyruar të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara dhe rëndësinë e përgjegjësisë së tyre të votës;
6. Dalje në media nga personat me aftësi të kufizuara për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe përfshirjes në diskursin publik elektorale.
7. Ngritja e problemit të mungesës së aksesit në qendrat e votimit, në diskutime dhe të pasqyrohen rekomandimet e drejtpërdrejta për institucionet përkatëse për garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara.